

VENDIM
Nr. 156, datë 1.3.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1455, DATË 21.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR GARDËN E REPUBLIKËS, TË DISA MJEDISEVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përmasat e pronës që i bashkëlidhet vendimit nr. 1455, datë 21.5.2008, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me përmasat e pronës me numër rendor 5 (pesë), sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Formulari përbëhet, gjithsej, nga 1 (një) fletë dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Garda e Republikës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUJTËSHME SHETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni I Pushtetit Vendor MPB (Garda e Republikës) Bashkia Tiranë Fusha e Përdorimit të Pronës Ruajtje Personaliteteve Shtetërore dhe ORV				Identifikuesi: Ngr. Anna Arapi nr. 13, N 000074 Supervisor: Thelëza KUSHTA - Teknike Ndërtimit Nënkomandant Astrit HITAJ - Kryetar Degë Logjistike APROVOI Jeral Grangor SAKO - Komandanti i Gardës Republikës				MIRATOI MINISTRI PUNËVE TË BRENDSHME Saimir TAHIRI			
NR	A			B			C				
	Zona Kadast indeksi hartës	Nr. Pasurive	Emërtesa e pronës Vendodhja	Komponen. Përbërëse të Pronës	Sipërfaqja totale e pronës m ²	Nga sip. totale sa ndërtesa m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues statusi juridik i pronës	Të dhëna të tjera shënime të veçanta	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
			Garda e Republikës								
5	8280		Komanda Gardës		14878.5	2223.05				Ndryshim në metra	
			Ish Reparti 1050								
			Pallati Brigadave								
				S. 1 Godin		513.3	Zyra, serverat	MPB	Garda e Republikës	Dy kate tullë	
				S. 2 Godin		777.2	Zyra, muzeu	MPB	Garda e Republikës	Një kat tullë	
				S. 3 Godin		38.25	Bar - Kafe	MPB	Garda e Republikës	Një kat tullë	
				S. 4 Godin		201.2	Zyra, palestër	MPB	Garda e Republikës	Dy kate tullë, podrum	
				S. 5 Godin		198.6	Sall konferencash	MPB	Garda e Republikës	Një kat tullë	
				S. 6 Godin		448.5	Garazhet	MPB	Garda e Republikës	Një kat tullë	
				S. 7 Godin		46	Informacioni	MPB	Garda e Republikës	Një kat tullë	
	Shënim		Trull Funksional		12655.45						
			Sip. Ndërtimore			2223.05					